

---

**Ligji 92/2014 date 24.07.2014**  
**PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË RSH**

**Neni 107 Afati i paraqitjes së deklaratës dhe periudha tatimore**

1. Deklarata e TVSH-së e bërë në përputhje me nenin 106, të këtij ligji, duhet të dorëzohet jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, periudha tatimore është muaji kalendarik përveç rasteve kur në këtë nen përcaktohet ndryshe.

3. Për një person të tatueshëm që regjistrohet fillimisht, periudha tatimore fillon në ditën kur certifikata e regjistrimit shënon se regjistrimi hyn në fuqi dhe përfundon në ditën e fundit të atij muaji.

4. Për një person të tatueshëm që çregjistrohet, periudha tatimore fillon në ditën e parë të muajit përkatës dhe përfundon në ditën në të cilën personi është çregjistruar.

5. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim që për ndonjë kategori personash të tatueshëm periudha tatimore të jetë më e gjatë se një muaj, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.

5. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, periudha tatimore të jetë më e gjatë se një muaj, por jo më e gjatë se një vit kalendarik. (Ndryshuar me ligjin 107/2017 dt.30.11.2017)

**Neni 109 Deklarime të tjera**

1. Autoriteti tatimor mund t'i kërkojë dhe t'i lejojë personit të tatueshëm të bëjë deklaratime të tjera, si shtesë e deklaratave për periudhat tatimore, në përputhje me nenin 67, të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast deklarimi bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të këtij ligji.

2. Të gjithë personat, të cilët, në zbatim të këtij kapitulli, kanë detyrimin për të dorëzuar deklaratën e TVSH-së, duhet ta shoqërojnë çdo deklaratë për një periudhë të caktuar tatimore me regjistrat përmbledhës mujorë si për furnizime të kryera, dhe për furnizime të marra dhe saktësime të tyre, të emërtuar përkatësisht libër shitjeje dhe libër blerjeje. Në këtë rast deklarimi bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, regjistrat përmbledhës që shoqërojnë deklaratën e TVSH-së, të jenë për një periudhë më të gjatë se muaji, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.

(Shtuar me ligjin 107/2017 dt.30.11.2017)

3. Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e librit të shitjes dhe librit të blerjes.

**Neni 117 Objekti i regjimit të bizneseve të vogla**

1. Personat e tatueshëm rezidentë në Shqipëri, qarkullimi vjetor i të cilëve është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, janë objekt i regjimit për bizneset e vogla, duke përfituar një përjashtim nga detyrimi për të llogaritur TVSH-në në shitje për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera prej tyre.

2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, rastet e përjashtimit apo kufiri minimal i regjistrimit për kategori të veçanta, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

(Ndryshuar me ligjin 107/2017 dt.30.11.2017)

3. Nuk përfshihen në regjimin e bizneseve të vogla, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, personat e tatueshëm që kryejnë veprimtari ekonomike që përbën evazion fiskal sipas kuptimit të nenit 116, të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

---

**VENDIM Nr. 953, datë 29.12.2014**  
**Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, Per Tvsh-ne**

**Neni 11 Përcaktimi i kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-ne**

1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 milionë (pesë milionë) lekë në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni. (Ndryshuar me VKM 652 dt.10.11.2017)

2. Personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelerisë, (Hequr me VKM 652 dt.10.11.2017) pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit.

3. Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, për prodhuesit bujqësorë që i nënshtrohen regjimit të veçantë, skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë, është qarkullimi prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh në një vit kalendarik. (Shtuar me VKM 652 dt.10.11.2017)

**Udhëzimi Nr. 6 , datë 30.01.2015**  
**“Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSh”**

**Neni 76 E Drejta e Zbritjes së TVSH-së**

1. Bazuar në nenin 121 pika 1 të ligjit, personat e tatueshëm, të cilët përfitojnë nga përfshirja në këtë regjim, nuk gëzojnë të drejtën e zbritjes së TVSH-së në përputhje me kreun X, të ligjit. Kështu TVSH e paguar nga personi i tatueshëm në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të blera nuk është e zbritshme, përsa ai duke iu nënshtuar këtij regjimi përfiton nga përjashtimi për të llogaritur TVSH-në.

2. Bazuar në nenin 83 të ligjit, personi i tatueshëm i cili kalon kufirin minimal të regjistrimit të TVSH-së dhe për pasojë i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, si dhe personi i cili regjistrohet vullnetarisht në këtë regjim ka të drejtë që në periudhën e parë tatimore kur bëhet person i tatueshëm i regjistruar, të njohë TVSH-në e zbritshme për mallrat e inventarit gjendje në datën e regjistrimit në këtë regjim, mallra këto me qëllim për t'u shitur, për të cilat do të llogarisë TVSH në shitje.

3. Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar këtë të drejtë janë si më poshtë:

a. mallrat do të shërbejnë për kryerjen e furnizimeve të tatueshme që kanë të drejtën e zbritjes. Nëse e drejta e zbritjes së TVSH-së është ushtruar ndërkohë që mallrat stok i shërbejnë furnizimeve të përjashtuara, atëherë duhet të bëhet rregullimi i TVSH-së së zbritur sipas përcaktimeve të ligjit.

b. personi i tatueshëm duhet të disponojë listën e mallrave stok të specifikuar në sasi dhe në vlerë, ku të evidentohet data e regjistrimit të stoqeve. Ky inventar duhet të dorëzohet në organin tatimor në momentin e regjistrimit në regjimin normal të TVSH-së dhe të jetë i evidentuar në regjistrat dhe kontabilitetin e personit të tatueshëm.

c. Cdo mall i përfshirë në inventar duhet të jetë i justifikuar me faturë tatimore të blerjes me TVSH, i blerë jo më parë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë, në përputhje me ligjin.

Bazuar në nenin 83 të ligjit, nëse personi i tatueshëm ka rezultuar me tepriçë të TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi si rezultat i TVSH-së së zbritshme të mallrave stok në momentin kur bëhet person i tatueshëm, atëherë ky person nuk ka të drejtë që të bëjë kërkesë për rimbursim të kësaj TVSH-je.